



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:043539

Datë: 11.07.2023

Numri i dokumentit: 04473817

C.nr.705/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil gjyqtarja Edije Sezairi, me praktikanten gjyqësore N.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.I. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson sipas av. S.M.N. nga Prizreni, Rr.’’.....’’ kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të kontestit padi për kompensimin e shujtave, dhe vlerë të kontestit 362.00 euro, me datën 07 korrik 2023, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditëses S.I. dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim ditor shujtën t’ia paguaj paditëses shumë prej 362.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

II. DETYROHET e paditura që t’ia paguajë paditëses shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 124 euro në afat prej 7 nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja S.I. nga Prizreni, përmes të autorizuarës së saj sipas av. S.M.N. nga Prizreni, Rr. ’’.....’’ pranë kësaj gjykate me datën 4 mars 2022 ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të kontestit padi për kompensimin e shujtave, dhe vlerë të kontestit 362.00 euro.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës të datës 30 qershor 2023 në afatin e paraparë ligjor ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Ka theksuar se paditësit në padi nuk paraqesin fakte se janë anëtarë të sindikatës, nuk e dëshmojnë me anë të kartelës së anëtarësisë kanë ushtruar padi pa përfunduar procedura administrative sepse nuk i kanë vazhduar procedurat në inspektoratin e punës në Prizren.

Gjithashtu ka arsyetuar se në mungesës së mjeteve buxhetore ngase Ministria e Financave nuk ka kod të posaçëm buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë. Komuna e Prizrenit rrezikon planifikimin buxhetor dhe në këtë mënyrë nuk mund të bëjë tejkalimin buxhetor të planifikuar për vitin 2023. Nga të gjithë të lartë përmendurat i ka propozuar Gjykatës Themelore në Prizren që pas administrimit të provave të refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

Për vërtetimin e plotë dhe real të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova:

-Kontratë pune për mësimdhënës e lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit me nr. të protokollit 46 e datës 20.10.2015.

-Vërtetimin e lëshuar nga SH.F.M.U'' Ardhmëria'' në Landovicë me numër të protokollit 109/2022 të datës 23.02.2022.

Nga provat e administruara më lartë nuk është kontestues fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune si mësimdhënëse tek e paditura SH.F.M.U'' Ardhmëria'' në Landovicë , por mbetet kontestues fakti se paditësës a i takon kompensimi për ushqimin ditor për shujtat për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësves si të bazuar për shkak se kjo kërkesë e paditësës është e rregulluar me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë 013 nr.2056 dt.18.04.2017 konkretisht të nenit 35.7 i cili rregullon të drejtën për shujta- ushqim ditor për ditët e kaluara në punë, në rastet kur punëdhënësi nuk e ka organizuar ushqimin në punë sikurse në rastin konkret.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësës, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësës t'ia kompenzon ushqimin ditor në shumën më detalisht të vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke llogaritur një ditë pune nga 2 euro për shkak se provat materiale konkretisht vërtetimet e lëshuara nga vet e paditura vërtetohet se paditësja ka qenë 181 ditë pune të përcaktuara gjithashtu detalisht sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenin 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124 euro, dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104 euro dhe në emër të taksës për padi 20 euro bazuar në tarifën e OAK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.705/22 me datë 07 korrik 2023

Praktikantja gjyqësore
Nimet Demiri

Gjyqtarja
Edije Sezairi

UDHËZIME PËR ANKESË: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.